

Tema: Sistemi penitenciar në Shqipëri dhe trajtimi I grupimeve etnike kulturore dhe fetare në të.

Sistemi i burgjeve , për nga popullata qe strehon konsiderohet një mozaik kulturor, ose siç përdoret shpesh nje “melting pot”, ku përfshihen njerëz të kulturave, besimeve, etnive, origjinave, prirjeve, vlerave, gjuhëve , zakoneve, të ndryshme. Në këtë mozaik, ka një grup të dënuarish ose të paraburgosurish që përbëjnë shumicën, pra që janë të një etnie, të nje besimi, të një orjentimi seksual, te nje origjine pra homogjen. Në këto raste ekziston mundësia që grupet e tjera që janë pakice, të bëhen objekt dhunimi dhe diskriminimi nga të burgosurit e tjerë apo nga stafi. Diskriminimi, për shkak të paragjykimeve dhe stereotipeve është një dukuri qe ndeshet edhe në jetën e lirë e aq më tepër në institucionet e ekzekutimit të veprave penale, aty ku njerëzit, ëndërrojnë dhe luftojnë për gjënë më të shtrenjtë që është liria. Për parandalimin e çdo lloji keqtrajtimi dhe diskriminimi, për arsye te tilla si raca, ngjyra, seksi, gjuha, feja, mendimi politik ose tjetër, origjines kombetare a shoqerore, pasurise, lindjes apo tjetër, në trajtimin e personave në konflikt me ligjin , mbi të cilët është imponuar një masë ose sanksion, me arrest në burg apo dënim me burg, I kushtohet një vëmendje e madhe trajnimit të stafit.

Nëpërmjet trajnimeve, stafit të shërbimit të burgjeve I jepet mundësia të kuptojë, çfarë është diskriminimi, paragjykimi dhe pse të kuptuarit e diversitetit kulturor ka një rëndësi të madhe për misionin korrektues të institucioneve të vendimeve penale.

Cilet janë faktorët që mund të sjellin keqkuptime, konflikte dhe paragjykime, midis njerëzve të kulturave të ndryshme dhe si mund ti minimizojmë dhe shmangim ato. Përfitimet që sjell njohja dhe pranimi I diversitetit kulturor,

Sigurisht, njerëzit kanë shumë përfitime nga njohja e kulturave të ndryshme. Megjithatë, aftësimi i punonjësve të shërbimit të burgjeve në lidhje me shumëllojshmërinë kulturore sjell përfitime të veçanta, si p.sh.:

- pakëson konfliktet e dhunshme midis të dënuarve dhe punonjësve të shërbimit;
- pakëson konfliktet dhe mosmarrëveshjet midis të dënuarve me njëri-tjetrin;
- rrit frymën e bashkëpunimit midis grupeve të ndryshme sociale;
- siguron mbrojtje më të mirë për grupet e pambrojtura, pakicat, romët etj.;

- mundëson ri integrimin e të gjitha grupeve që ndodhen të dënuar;
- rrit sigurinë dhe besimin midis grupeve të ndryshme.

Për të njohur dhe kuptuar kulturat që dallojnë nga kultura jonë, duhet të jemi të hapur dhe të kemi vullnet për të mësuar. Kjo nuk është detyrë e lehtë, por secili prej nesh, si punonjës i një shërbimi publik të një shteti që ka pakica kombëtare dhe grupe në nevojë, duhet ta vlerësojmë këtë aspekt me mendje të hapur. Çfarë mësojmë dhe përfitojmë nga kulturat do të na përmirësojë pozitën tonë si punonjës të shërbimit.

Barazia e shtetasve përbën një parim kushtetues, i cili është sanksionuar thuajse në të gjitha Konventat dhe rekomandimet mbi të drejtat e njeriut. Ky parim theksohet në Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe specifikisht për personat e burgosur theksohet në Ligjin 8328, date 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të burgosur” në akte të tjera ligjore e nënligjore kombëtare, në RSM, Rregullat Standart Minimum, në Rregullat Europiane të Burgjeve REC 2006(2), Ne REC 2008 (11), në Parimet themelore të trajtimit të të burgosurve Rezoluta 45/111 14 dhjetor 1990 etj. Të gjitha këto akte janë të përkthyer dhe janë të aksesueshme nga stafi si dhe kanë qënë objekt i trajnimit të stafit.

Ekzekutimi i dënimit me burgim bëhet duke respektuar dinjitetin e të dënuarit dhe përshkohet nga ndjenja njerëzore. Trajtimi i të dënuarve bëhet pa njëanshmëri apo diskriminim për shkak të seksit, kombësisë, racës, gjendjes ekonomike dhe shoqërore, pikëpamjeve politike dhe besimit fetar. Të dënuarve duhet t’u sigurohen kushte jetese të tilla që ulin në minimum efektet paragjyquese negative të burgimit dhe ndryshimet me jetën e shtetasve të tjerë. Trajtimi i tyre realizohet sipas kriterit të individualizimit në përputhje me gjendjen dhe karakteristikat individuale të secilit të dënuar. Individualizimi gjithashtu arrihet duke verifikuar nevojat individuale dhe duke marrë parasysh kushtet dhe mjedisin në të cilin i dënuari ka jetuar, shkaqet edukative dhe shoqërore që e kanë larguar atë nga jeta normale. Në aktivitetin e përditëshëm realizohet vëzhgimi i cili bëhet në fillim të trajtimit dhe rezultatet e tij verifikohen vazhdimisht gjatë ekzekutimit të vendimit penal, duke bërë përshtatjet e duhura. Vëzhgimi, programimi dhe realizimi i trajtimit bëhet nga administrata e institucionit me anë të personelit të vet, në bashkëpunim me organet dhe institucionet shtetërore përkatëse. Kontributi i organizatave

joqeveritare dhe individëve të veçantë, inkurajohet dhe mbështetet nga administrata e burgjeve në realizimin e programit të trajtimit.

Trajtimi i të dënuarve bëhet duke siguruar mjediset e përshtatshme dhe në përputhje me të dhënat e personalitetit të tyre.

Objektivat e trajtimit përfshijnë arsimimin, formimin profesional, zhvillimin e aftësive të tjera individuale, veprimtaritë kulturore, çlodhëse e sportive, punën, asistencën shpirtërore dhe veprimtari të tjera në grup që kanë si qëllim rikrijimin e aftësisë për t'i integruar në shoqëri.

Trajtimi social-edukativ i të dënuarve zhvillohet me anë të veprimeve individuale dhe të veprimtarive formuese, që realizohen nga ana e personelit të burgjeve të aftësuar posaçërisht në fushën pedagogjike, në bashkëpunim me punonjësit e tjerë të institucionit.

Kushtet e punës duhet të jenë si në shoqërinë e lirë, me qëllim që të dënuarit të përfitojnë aftësi profesionale për të lehtësuar riintegrimin e tyre në shoqëri.

Të dënuarit që tregojnë aftësi për veprimtari shkencore, kulturore, artistike ose të artizanatit, mund të lejohen që të ushtrojnë me shpenzimet dhe për llogari të tyre këto veprimtari.

Puna është me shpërblim dhe përfshihet në vjetërsinë në punë për efekt pensioni.

Objekti i punës duhet t'u përshtatet kërkesave të veçanta të personalitetit të secilit nga të dënuarit në perspektivën e ri integritit në shoqëri.

Kur në institucion nuk është e mundur të sigurohet puna për të dënuarit, tërësisht ose pjesërisht, mund të sigurohen fronte pune jashtë institucionit, duke aktivizuar të dënuarit me kriterin e aftësisë për punë, formimin profesional dhe duke preferuar moshën relativisht të re.

Arsimimi dhe formimi kulturor e profesional bëhet me anë të organizimit të shkollës, e detyrueshme për të miturit, si dhe të kurseve profesionale, sipas sistemeve në fuqi.

Nxitet kryerja dhe favorizohet ndjekja e studimeve profesionale, duke përdorur kurset me korrespondencë, gjithashtu favorizohet leximi pa kufizim i publikimeve dhe përdorimi i sistemeve të tjera informative të bibliotekës së institucionit.

Kujdes i veçantë i kushtohet formimit kulturor e profesional të të dënuarve me moshë nën 25 vjeç. Në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe riedukimit, sipas kërkesave të trajtimit, kemi arritur me një punë me shumë përgjegjesi dhe dashuri të sigurohen mjediset dhe mjetet e përshtatshme dhe të nevojshme për zhvillimin e punës, arsimimin shkollor dhe profesional, veprimtaritë çlodhëse, kulturore dhe çdo veprimtari tjetër të përbashkët ose individuale.

Institucionet tona pa përjashtim janë të pajisura me një bibliotekë librash dhe botime periodike.

E drejta e besimit dhe ushtrimi i riteve fetare sipas Rregullores së përgjithshme të Burgjeve.

-Të dënuarit kanë të drejtën e besimit dhe të ushtrimit të riteve fetare. Për ushtrimin e riteve, institucioni siguron mjedise të veçanta.

-Të dënuarit kanë të drejtë të marrin kontakt me përfaqësues të komuniteteve fetare, të caktuar në marrëveshje mes Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe komuniteteve fetare të njohura ligjërisht.

Trajtimi i grupeve etnike/kulturore e fetare në sistemin penitenciar.

Trajtimi i të gjithë kategorive të të burgosurve në sistemin e burgjeve mbështetet në Konventat Ndërkombëtare të Ratifikuara nga shteti shqiptar dhe që garantojnë respektimin e të drejtave të njeriut si dhe në Rregullat Europiane të Burgjeve. Të burgosurit që i përkasin minoritetit etnik, kulturor apo besimeve fetare, gëzojnë të njëjtat të drejta ashtu si kategoritë e tjera të të burgosurve. Të drejtat e tyre garantoohen nga Ligji nr. 8328 dt.16/04/1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” të ndryshuar, (neni 5 “Respektimi i të Drejtave të Njeriut” dhe neni 42 “E drejta e besimit dhe ushtrimi i riteve fetare”), dhe VKM nr. 303 dt.25/03/2009, “Per miratimin e Rregullores se Pergjithshme te Burgjeve”, të ndryshuar. Mbështetur në RRPB, njohja me të drejtat e të burgosurve bëhet ashtu si edhe për kategoritë e tjera që në momentin e pranimit të tyre në një institucion penitenciar (mbështetur në nenin 5 “Njohja e të burgosurit me të drejtat dhe detyrimet”).

Çdo të pranuari në I.E.V.P. i bëhen të ditura të drejtat dhe detyrimet e tij, që rrjedhin nga ligji, kjo rregullore dhe rregullorja e brendshme e I.E.V.P. Për këtë qëllim nga administrata e IEVP, i vihen në dispozicion aktet e nevojshme ligjore e nënligjore. Për të burgosurit që nuk dinë shkrim e lexim, komunikimi i akteve bëhet me gojë nga personeli përkatës. Të burgosurit që nuk dinë gjuhën shqipe, i vihen në dispozicion këto akte në një gjuhë që ai e kupton.

Mbështetur në nenin 41 të kësaj rregulloreje mbi “Të drejtat e të burgosurve”, pika (i), krahas të drejtave të tjera, të burgosurve u njohet e drejta “Të ushtrojnë besimin dhe ritet fetare”;

-Per ushtrimin e aktiviteteve fetare nga të burgosurit , po marr disa shembuj për ta konkretizuar me tej punën e kujdeseshme që bëhet nga stafet drejtuese.

Në institucionin e Krujës është marrë në konsideratë dëshira e personave të interesuar për pjesëmarrje , janë krijuar kushtet e favorshme për ushtrimin e riteve fetare sipas besimit fetar që kanë dhe në institucion janë dy ambiente të veçanta kulti, një për besimtarët myslimanë dhe një ambient tjetër për besimtarët katolikë. Keto ambiente janë të dekoruara dhe të pajisura sipas besimeve përkatëse. Aktivitetet monitorohen edhe nga stafi me qëllim mbarëvajtjen e tyre.

Për secilin besim fetar të përmendur më sipër i burgosuri pjesëmarrës mund ti ushtrojë ritet fetare në harkun kohor prej 2 orësh ne javë.

Në total 42 të burgosur janë të interesuar të ndjekin besimet fetare rregullisht.

-Në institucionin e Rrogozhinës ju është krijuar mundësia për ndjekjen e riteve fetare duke respektuar të drejtën e besimit.Ritet fetare kryhen në ambientet e posacme te kultit, në xhami dhe në ambientet kishës.

-personat që i perkasin besimit kristian-orthodoks-katolik i ndjekin një herë në jave nga një ore.

-personat që i perkasin besimit musliman i zhvillojnë faljet një herë në javë, faljen e xhumasë.

Krahas përvojës së mirë dhe interesimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë, Qeverisë së Shqipërisë, dhe institucioneve të tjera, që janë sensitive në këtë drejtim, ka dhe mangësi të dukshme për të cilat nevojitet ndërhyrje nga shoqata dhe organizma te ndryshme kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Si shembull do të sillja ato I.E.PV. si “ Mine Peza” e cila nuk ka ambiente kulti dhe për të kryer ritet fetare massive (festa) të dënuarit I bëjnë në ambientet e oborrit të brendshëm të institucionit. Ndërkohë që për sa I përket kryerjes së shërbesave fetare për besimtarët katolik, është bashkëpunuar me Kishën Katolike dhe Motrat Nënë Tereza.Janë kryer aktivitete në zhvillimin e predikimeve fetare, kurseve të katekizmit, pagëzimeve, festimin e Krishtlindjeve, Pashkëve etj. Përsa I përket kremtimit të festive për besimtarët muslimanë gjatë muajit të Ramazanit është bashkëpunuar me subjekte që kanë ofruar shtrimin e Iftarëve për këta persona.

Te dhëna statistikore mbi grupet etnike/culture fetare në I.E.P.V. Penale

Nr.	I.E.V.P.	Minoritet etnik (nr.)	Minoritet kulturor/rome (nr.)	Besimtarë që ndjekin ritet fetare		Të pajisura me ambiente fetare
				M	K/O	
1.	Tropojë	-	-	9	9	
2.	Kukës	-	-	9	-	X
3.	Lezhë	-	29	104	119	X
4.	Burrel	-	-	31	11	
5.	Fushë-Krujë	-	13	52	65	X
6.	Krujë	-	-	15	24	
7.	Jordan Misja	-	7	30	12	
8.	Ali Demi	1	26	28	96	X
9.	Mine Peza	-	16	50	20	
10.	Vaqarr	-	20	9	10	
11.	QSB		-	2	3	
12.	Durrës	-	30	31	40	X
13.	Kavajë	-	2	-	-	X
14.	Rrogozhinë	-	21	20	23	X
15.	Peqin	-	85	150	42	X
16.	Korçë	3	20	80	50	X
17.	Lushnje	-	26	25	15	
18.	Berat	-	3	-	2	
19.	Vlorë	-	15	15	-	X

20.	Tepelenë	-	10	15	5	
21.	Sarandë	1	2	2	10	

Gjithësej në sistemin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve kemi 645(gjashtëqind e dyzetë e pesë) persona të cilët praktikojnë ritet fetare të muslimanizmit, 556(pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) prej tyre praktikojnë ritet Kristiane dhe Katolicizmit, dhe po në këtë sistem ndodhen 324(treqind e njëzetë e katër) persona të grupimit Romë dhe 5(pesë) persona të minoriteteve etnike.

Trajnimet:

Ne lidhje me trajnimin e stafit të shërbimit të burgjeve mbi çështje të mosdiskriminimit dhe të diversitetit kulturor, ju sqarojmë:

Qendra e Trajnimit zbaton dy programe, baze dhe niveli i mesëm i menaxhimit, si dhe zhvillon trajnime specifike, për aspekte të veçanta si trajtimi i grupeve të vulnerabël, ku hyn edhe grupet e ndryshme etnike, ose pakicat.

Ne programin baze një temë dy orëshe titullohet “Nderthurja kulturore”, ku jepet njohuri për koncepte dhe parimet e trajtimit të grupeve të ndryshme. Njëkohësisht në programe parashikohet edhe një temë tjetër mbi të drejtat e të burgosurve dhe të drejtat e njeriut në përgjithësi, ku punonjësit trajtohen mbi parimet kryesore të trajtimit, siç është rasti i parimit kushtetues të mosdiskriminimit.

Krahas trajnimeve që zhvillon Sektori i Trajnimeve, nga sektorët social me stafin e sigurisë dhe të burgosurit zhvillohen tema sociale të tilla si: “Paragjykimi /Diskriminimi”, “Njohja me të drejtat dhe liritë e njeriut sipas legjislacionit kombëtar në fuqi”, “Komunikimi dhe etika e komunikimit”, etj.

Për të qënë të sinqertë sepse vetëm kështu mund të ndihmojmë këto grupime trajnimet nuk kanë munguar por nuk janë të mjaftueshme.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me shoqata të ndryshme që promovojnë të drejtat e njeriut duke përfshirë në fokusin e tyre edhe grupet etnike, kulturore e fetare në burgje. Për mbrojtjen e të drejtave të grupeve specifike DPB bashkëpunon me Avokatin e Popullit, KSHH, QSHRTT, CRCA, etj.

Shoqatat fetare që operojnë në këtë drejtim janë: Shoqëria Kristiane e të Burgosurve Shqiptar (SHKBSH), Shoqata e Grave Kristiane (YËCA), Dëshmitarët e Jehovait, Shoqata për Korrektim

dhe Rehabilitim Njerëzor, CARITAS, Kishat Katolike dhe Ortodokse, Motrat e Nënë Terezës. Krahas mbështetjes për organizimin e aktiviteteve periodike fetare, këto shoqata kanë siguruar edhe literaturën fetare (libra, gazeta e revista periodike) në ato institucione ku operojnë.

Çdo I.E.V.Penale organizon aktivitete me rastin e festave fetare si Bajrami, Krishtlindjet, Pashkët, etj. Me rastin e festave të Bajramit dhe Pashkëve organizohen dreka festive.

Të burgosurit që i përkasin minoritetit kulturor rom, trajtohen dhe përfshihen në programe rehabilituese ashtu si edhe kategoria tjetër e të burgosurve. Ata janë të integruar në komunitet dhe janë të angazhuar në aktivitete të punësimit, arsimimit dhe formimit profesional.

Në momentin e pranimit në institucion për çdo të burgosur krahas të dhënave të tjera, bëhet regjistrimi i kombësisë. Informacioni mbi përkatësisë fetare apo ushtrimin e riteve fetare merret nga sektorët social. Mbështetur në këtë informacion dhe vullnetin e tyre të lirë ata angazhohen në aktivitete e përjavshme që organizon institucioni apo shoqatat fetare.

Shprehje e trajtimit të duhur dhe respektimit të parimit njerëzor dhe të barabartë, është se nuk ka asnjë rast të referuar nga të burgosurit apo nëpërmjet organizmave të tjerë promovues të të drejtave të njeriut, të diskriminimit të të burgosurve nga personeli i burgjeve, për shkak të përkatësisë etnike, kulturore apo besimit fetar.

Gjithashtu nuk janë konstatuar raste konflikti as ndërmjet të burgosurve, për shkak të përkatësisë etnike, kulturore apo fetare. Ky është tregues i bashkëjetesës së mirë ndërmjet grupeve të të burgosurve.

DPB nuk ka informacion mbi ekzistencën e shoqatave të familiarëve të të burgosurve.

**Zv Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve
Iliaz LABI**